1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kriterëve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:*[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]*, përfshirë sgarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne *[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]*, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës *[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]*.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 2. Njoftimin e Kontratës;
 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- [**Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë**];

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
A Dieta për të rritur					
1.	Dieta Ditore Nr.1 (Dietë Normale)	17,847			
2.	Dieta Ditore Nr.2 (hidrike A)	16,051			
3.	Dieta Ditore Nr.3 (Sëmundjet Infektive)	17,787			
4.	Dieta Ditore Nr.5 (Dietë e qullët, ½ e lëngët)	884			

5.	Dieta Ditore Nr.8 (Dietë për ulcerozët Hipo Normakalori)	2,646			
6.	Dieta Nr.12 (Diabetike me diabet të ekuilibruar)	6,115			
7.	Dieta Nr.13 (Dietë Normokalorike shumë e varfër në Na	45,798			
8.	Dieta Nr.14 (Dietë Onkologjike)	33,838			
B Dieta Për Fëmijët					
9.	Dieta Nr.1 A Normale	414			
10.	Dieta Nr.1 B Normale	410			
11.	Dieta Nr.1 C Normale	3,812			
12.	Dieta Nr.1 D Normale	3,808			
13.	Dieta Nr.2 A Normale	2,030			
14.	Dieta Nr.2 B Normale	2,922			
15.	Dieta Nr.2 C Normale	7,434			
16.	Dieta Nr.3 A	3,248			
17.	Dieta Nr.3 B	4,943			
				Çmimi total	_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					
Çmimi total me TVSH:					
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit					
Nënshkrimi					
Vula					
Datë _____					

Shtojca 3.

[*Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik*)

[*Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve*]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [*Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor*]

Në emër të: [*Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar*]

* * *

Procedura e prokurimit [*lloji i procedurës*]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [*objekti*]

Publikimi (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [*Data*] [*Numri*] / Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [*emri i autoritetit/entit kontraktor*] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik "....." për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik "....." të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Kontrata do të ketë elemente kryesore: Shërbim Gatim dhe Shpërndarja e Ushqimit (Katering) në pavionet e Spitalit Rajonal Vlorë.

Operatori ekonomik që do të kontraktohet, duhet të ofrojë një shërbim i cili do të përfshijë:

Përgatitjen dhe gatimin e ushqimit sipas kërkesave dhe dietave të përcaktuara nga Spitali Rajonal Vlorë, në bazë të kërkesave higjeno sanitare dhe standarteve të kërkuara:

- Paketimin sipas dietave dhe racioneve të kërkuara;
- Transportin e ushqimit të gatuar deri tek pavioni sipas shërbimeve dhe orareve të servirjes;
- Shpërndarjen e ushqimit të gatuar në të gjitha shërbimet dhe pavionet e Spitalit Rajonal Vlorë,
- Servirjen e ushqimit brenda të gjitha parametrave në orarin e caktuar sipas dietave deri tek pacienti dhe mjeku roje në shërbim 24 ore mbi 24orë;

Shërbimi do të ofrohet gjatë gjithë javës prej ditës së hënë deri ditën e diel sipas vakteve dhe fletë porosisë së Spitalit si dhe shtesave të racioneve që mund të jenë të nevojshme gjatë fundjavës por dhe sipas kërkesës së Kryeinfirmiereve të pavionit në rast të shtrimeve të reja dhe të paraportuar në forcen ditore, të cilat do të rakordohen me Sektorin e Hotelarisë.

Në mënyrë të detajuar, jepet në vijim përberja e dietave që do të zbatohen në Spitalin Rajonal Vlorë:

SPECIFIKIMET TEKNIKE PËR DIETAT

Nr	Përshkrimi i dietave
	Dieta për të rritur
1	DietaDitore1(DietaNormale) 2773k.kal.(Prot.100gr,lipide77gr,glucide420gr)
2	DietaDitore2(HidrikeA) 102k.kal.(Prot.3.5gr,lipide9.8gr,glucide0gr)
3	DietaDitore3(Semundjetinfektive) 2613k.kal.(Prot.80gr,lipide61gr,glucide436gr)

4	Dieta Ditore 5 (Diete e qullet , 1/2 e lenget) 1616 k. kat. (Prot.80gr,yndyrna J2 gr,glucide 297 gr)
5	Dieta Ditore 8 (Diete per ulcerozet- Hipo e Norma kalorike) 1857 k. kal. (Prot.80gr,lipide 57 gr,glucide 256 gr)
6	Dieta Ditore 12 (Diete diabetike me diabet te ekuilibruar) Varion nga 800-3000 kkal
7	Dieta Ditore 13 (Diete Normokalorike-shume e varfer ne Na) 2280 k. kal. (Prot.90gr,lipide 64 gr,glucide 336 gr)
8	Dieta Ditore 14 (Diete onkologe) 3000 k. kal. (Prot.122gr,yndyrna 108 gr,glucide 385 gr)
	Dietat Pediatrike
➤	Dieta Ditore 1 Diete normale Pediatrike,per te gjitha semundjet, e ndare ne 4 grup-mosha
1	Diete normale <u>1A</u> . Per femijet 1-4 muaj (~481.5kkal,prot 13.5gr,lip22.5gr,gluc 56.25gr)
2	Diete normale <u>1B</u> . Per femijet 4-6 muaj (~481.5kkal,prot 13.5gr,lip22.5gr,gluc 56.25gr)
3	Diete normale <u>1C</u> . Per femijet 6-8 muaj (~481.5kkal,prot 13.5gr,lip22.5gr,gluc 56.25gr)
4	Diete normale <u>1D</u> . Per femijet 8-12 muaj (~481.5kkal,prot 13.5gr,lip22.5gr,gluc 56.25gr)
➤	Dieta Ditore 2 Diete normale Pediatrike, e ndare ne 3 grup-mosha
5	Diete normale 2A. Per femijet 1-3 vjec (1400kkal,prot 43.4gr,lip52.2gr,gluc 189gr)
6	Diete normale 2B. Per femijet 3-6 vjec (1684kkal,prot 62gr,lip56gr,gluc233gr)
7	Diete normale 2C. Per femijet 6-14 vjec (2390kkal,prot 75gr,lip70gr,gluc365gr)
8	Dieta 3A(per semundjet virale,hepatite,tifo per grup moshen1-3 vjec (1213kkal,prot 38.5gr,lip50.2gr,gluc152gr)
9	Dieta 3B(per semundjet virale,hepatite,tifo per grup moshen 3-14 vjec (1858kkal,prot 66gr,lip66gr,gluc250gr)

Në mënyrë të detajuar, jepet në vijim përbërja e dietave që do të zbatohen në Spitalin Rajonal Vlorë:

➤ **DietaNr.1**

2773kkal (prot100gr, lipide77gr,glucide420)

Nr.	Asortimenti	Nj.m	Sasia

1	Qumesht	MI	300
2	Sheqer	Gr	15
3	Buke	Gr	250
4	Oriz/makarona	Gr	150
5	Zarzavate	Gr	500
6	Vaj	MI	30
7	Mish	Gr	150
8	Fruta	Gr	300
9	Djathe,gjize	Gr	80
10	Gjalp	Gr	10

➤ **Dieta Nr. 2 (HidrikeA)**

102kkal (prot3.5, lipide9.8, glucide0gr)

Nr.	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Leng mishi/Zarzavate	Gr	1000
2	Djathe i grire	Gr	100

Dieta Nr. 2 (Hidrike B1)

400kkal (prot0, lipide 0, glucide 100gr)

Nr	Asortimenti	Nj.M.	Sasia
1	Lengfrutash	Gr	1000
2	Sheqer	Gr	100

➤ **Dieta Nr.3**

2613kkal(prot.80gr,lip.61,gluc.436 gr)

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	MI	200

2	Sheqer	Gr	20
3	Recel/prevede	Gr	100
4	Orisose makarona	Gr	130
5	Buke	Gr	160
6	Vaj	MI	30
7	Gjalpe	Gr	5
8	Mish	Gr	140
9	Patate	Gr	200
10	Zarzavate	Gr	200
11	Djathe pa kripe	Gr	100
11	Fruta	Gr	400

➤ **Dieta Nr.5**

1616 kkal (prot.80 gr.yndyrna 12gr. gluc.297gr.)

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	MI	700
2	Sheqer	Gr	60
3	Biskota	Gr	100
4	Vaj	MI	30
5	Oriz	Gr	50
6	Mish	Gr	120
7	Patate	Gr	200
8	Fruta	Gr	400
9	Djathe	MI	30
10	Veze	koker	1

➤ **Dieta Nr.8**

Hipokaloreke 1857kkal(prot.80gr.lip.57gr.gluc.256g.)

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	Ml	400
2	Sheqer	Gr	10
3	Zarzavate	Gr	350
4	Oriz/malcarona	Gr	100
5	Vaj	Gr	15
6	Mish	Gr	130
7	Fruta	Gr	500
8	Buke	Gr	120
9	Djathe	Gr	70

➤ **Dieta Nr.12**

(Kjo diete varion nga 800-3000kkal, diapason qe perfshin diabetiko -obeze dhe at ate dobet.)

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	Ml	600
2	Buke	Gr	150
3	Zarzavate	Gr	500
4	Veze	koker	1
5	Djathe	Gr	50
6	Gjalpe	Gr	20
7	Oris	Gr	100
8	Mish	Gr	100
9	Vaj	Ml	25
10	Fruta	Gr	500

➤ **Dieta Nr.13**

2280kkal(prot.90gr.lip.64gr.gluc.336gr.)

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	MI	200
2	Mish	Gr	100
3	Veze	kokerr	1
4	Gjize	Gr	50
5	Vaj	MI	30
6	Gjalpe	Gr	10
7	Zarzavate	MI	400
8	Fruta	Gr	350
9	Buke pa kripe	MI	160
10	Oriz	Gr	130

➤ **DietaNr.14~3000kkal(prot122gr,lip
108grgluc.385gr.)**

Nr	Asortimenti	Nj.m	Sasia
1	Qumesht/kos	MI	600
2	Mish	Gr	200
3	Vaj	MI	30
4	Gjalpe	Gr	15
5	Djadhe/gjize	Gr	100
6	Veze	kokerr	1
7	Sheqer	Gr	30
8	Oris	Gr	110
9	Zarzavate	Gr	500
10	Fruta	Gr	400

11	Buke	Gr	300
----	------	----	-----

DIETAT PEDIATRIKE

Dieta Nr.1 - Diete pediatrike e ndare me 4 grup- mosha

Diete normale 1A. Per femijet 1-4 muaj (~481.5kkal,prot 13.5gr,lip22.5gr,gluc 56.25gr}

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht (formule satandarte 1)	ml	750

Dietenormale 1B. Per femijet 4-6 muaj (~481.5kkal,prot 13.5gr,lip22.5gr,gluc 56.25gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht (formulesatandarte 1)	ml	750
2	Oriz (miell)	gr	5
3	Sheqer	gr	10
4	Perime (te stines)	gr	150

Dietenormale 1C. Per femijet 6-8 muaj (~481.5kkal,prot 13.5gr,lip22.5gr,gluc 56.25gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	330
2	Miell	gr	10
3	Perime (testines)	gr	250
4	Vaj	gr	35
5	Mish (ifresket, vici)	gr	50
6	Djathe (lope, ibardhe)	gr	15
7	Sheqer	gr	10
8	Fruta (te stines)	gr	100

Dietenormale 1D. Per femijet 8-12 muaj (~481.5kkal,prot 13.5gr,lip22.5gr,gluc 56.25gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia/matese	Sasia
1	Qumesht	ml	100
2	Mish (ifresket, vici)	gr	40
3	Djathe (lope, ibardhe)	gr	20
4	Fruta (testines)	gr	100
5	Veze (2 here/jave)	Kokerr	0.29

Dieta Nr2A Normale Per femijet 1-3 vjec (~1400kkal,prot 43.4 gr,lipide52.2, gluc 189 gr)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	300
2	Perime (te stines)	gr	380
3	Mish (ifresket, vici)	gr	40
4	Gjalp(lope)	gr	20
5	Sheqer	gr	35
7	Vaj lliri	ml	10
8	Buke (gruri)	gr	60
8	Fruta (testines)	gr	300
9	Veze(4 here ne jave)	kokerr	1

Dieta Nr 2B. Normale per femije 3-6 vjec, ~1684 k.kal
(prot.62, lipide 56Kg, gluc.233gr.)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	250
2	Recel	gr	30
3	Perime te stines	gr	500
4	Mish (ifresket, vici)	gr	60
5	Sheqer	gr	35
6	Vaj ulliri	ml	10
7	Djathe lope I bardhe	gr	60
8	Buke (gruri)	gr	190
9	Veze	kokerr	1
10	Fruta (testines)	gr	200

Dieta Nr 2C. Normale per femije 6-14 vjec, ~ 2390 k.kal
(prot.75, lipide 70gR, gluc.365gr.)

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	400
2	Buke gruri	gr	100
3	Perime te stines	gr	250
4	Vaj ulliri	ml	35
5	Mish (ifresket, vici)	gr	100
6	Fruta (testines)	gr	300
7	Djathe lope I bardhe	gr	70
8	Sheqer	gr	40
9	Makarona	gr	85
10	Biskota	gr	40

Dieta Nr.3A per semundje virale, hepatite, tifo, per grup moshen 1-3 vjec

~1213 k.kal (prot.38.5gR, lipde50.2g, gluc. 152gr.

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht	ml	330
2	Oriz	gr	20
3	Perime (te stines)	gr	430
4	Djathe (lope, ibardhe)	gr	20
5	Recel	gr	20
6	Vaj (ulliri)	mL	10
7	Sheqer	gr	35
8	Buke (Kguri)	gr	60
9	Fruta (testines)	gr	150

Dieta Nr 3B. per femije 3-14 vjec, ~1858 k.kal (prot.66gr, lipide.66gr, gluc.250gr.

Nr.	Asortimenti	Njesia	Sasia
1	Qumesht/kos	ml	500
2	Perime (te stines)	gr	200
3	Vaj (ulliri)	ml	35
4	Mish (ifresket, vici)	gr	100
5	Fruta (te stines)	gr	350
6	Djathe (lope, ibardhe)	gr	30
7	Sheqer	gr	40
8	Buke	gr	120
9	Oriz	gr	50

Specifikimet e artikujve ushqimorë që do të përdoren për zbatimin e dietave në Spitalin Rajonal Vlorë:

Buke gruri :

- Te jete e pjekur mire ne masen 1 kg pa ere myku ,thartire dhe hidherimi dhe ere e shije tjetër te huaj.
- Duhet të jetë me rreze 75% e gatuar brenda ditës dhe me miell të papërzier Cilesia te jete sipas standartit shtetëror Shqiptar.
- Buka duhet të jetë e prerë në feta dhe e ambalazhuar në qese prej letre dhe te dergohet per konsum jo me pare se 3 ore nga koha e pjekjes dhe te jete e shoqeruar me raport analize nga A.K.U
- Transporti I bukes te behet me mjete te pastra te mbrojtura nga demtimet e faktoret e tjere atmosferik duke zbatuar rregullat higjeno-sanitare per transportimin e produkteve ushqimore .

Makarona :

- Makaronat te jene cilesore ,te etiketuara sipas standartit shtetëror

-
- Makaronat te jene me ere te mire pa shije te hidhur ,te tharte,te mykur dhe cfaredo ere dhe shije tjeter te huaj
 - Te jene te ambalazhuar ne qese telefoni me masen 500 gr dhe te futura ne kuti kartoni .
 - Ne ambalazhimin 500 gr te jene te shenuar dhe afati I skadences mbi nje vit nga data e furnizimit.

Orizi :

- Te jete me kokrra te pasterta ,te zhveshura teresisht nga levozhga e orizit ,pa shije ,pa shenja myku ose prishje .
- Treguesit teknik te jene sipas Standartit Shteteror Shqiptar.
- Te jete I ambalazhuar ne pako 1 kg ku te jete shenuar afati I skadences mbi nje vit nga data e furnizimit.

Sheqer :

- Pluhuri te jete I perbere nga kristale te imet dhe te njellojte pa lende te huaja.
- Treguesit teknik sipas Standarteve Shteteror Shqiptar
- Ambalazhimi : te jete me pako prej letre 1 kg neto ku te jete shenuar edhe afati I skadences mbi 1 vit nga data e furnizimit.

Vaj gjelle :

- Te jete leng vajor , me ngjyre te verdhe me shije te mire karakteristike e vajit te lulediellit te rafinuar,pa shije dhe ere te huaj
- Treguesit kimik sipas Standartit Shteteror Shqiptar.
- Ambalazhimi do te jete ne shishe plastike me vellim 1 litershe.te mbyllur me tape plastike me vidhezim hermetike te kapsuluara me shirit PVC me stampen perkatese
- Mbi cdo shishe do te vendoset etiketa ne te cilen do te shenohet :
 - Emertimi I plote I mallit
 - Data e skadimit ose afati I perdorimit qe do te jete mbi nje vit nga data e furnizimit .

Vaj ulliri :

- Te jete leng vajor me ngjyre ulliri , pa shije dhe ere te huaj
- Treguesit kimik sipas standartit shteteror shqiptar
- Ambalazhimi do te behet ne shishe plastike ose qelqi me vellim 0.5 ose 1 lit ,te mbyllur me tape plastike me vidhezim hermetike te kapsuluara me shirit PVC me stampen perkatese.
- Mbi cdo shishe do te vendoset etiketa nete cilen te shenohet
- Emertimi I plote I mallit
- Data e skadimit ose afati I perdorimit qe do te jete mbi nje vit nga data e furnizimit

Biskota :

- Te jene cilesore ,me shije te mire ,pa shenja myku ose prishje .
- Treguesit kimik sipas standartit shteteror shqiptar
- Ambalazhimi do te jete ne qese telefoni 125-150 gr ku te jene te shenuar data e skadences mbi nje vit nga data e furnizimit

Miell gruri :

- Te jete pluhur I njetrajtshem pa lende te huaja insekte dhe demtues te tjere .

- Ngjyra e bardhe me ere te kendshme karakteristike e miellit te grurit pa ere dhe shije te huaj
- Treguesit kimik te jene sipas Standarti Shteteror Shqiptar
- Amballazhimi te jete ne pako letre 1 kg me etikete prodhuesi dhe afat skadence mni nje vit nga data e furnizimit .
- Rekomandime per perdorim ,nese keto ndikojne ne menyre te ndjeshme mbi afatet e ruajtjes se cilesise ose mbi vlerat e produktit ushqimor keto te dhena te jepen nbi amballazh dhe etikete.
- Rekomandime per perdorim ,nese keto ndikojne ne menyre te ndjeshme mbi afatet e ruajtjes se cilesise ose mbi vlerat e produktit ushqimor keto te dhena te jepen nbi amballazh dhe etikete.

Miell orizi:

- Ngjyra: E bardhë me nuancë ngjyre të verdhë.
- Era dhe shija: Karakteristike e miellit të orizit, pa shije të thartë e të hidhur, pa erë të mykur dhe erë të huaj.
- Treguesit fiziko-kimikë: Lagështia 12.8 %, Aciditeti 0.081 %. Lëndë të huaja jo më shumë se 0.2 %. Lëndë minerale nuk lejohen.
- Ngjyra e bardhe me ere te kendshme karakteristike e miellit te grurit pa ere dhe shije te huaj
- Amballazhimi i pakëtuar në qese letre me pesjë 0.5 kg – 1 kg.
- Markëtimi: Emrtimi i prodhuesit, Emërtimi i produktit. Pesha neto. Data e skadimit. Kushtet e veçanta të ruajtjes.
- Malli të shoqërohet me çertifikatë origjine dhe raport analize të laboratorit.

Niseshite :

- Te jete e cilesise se pare e stazhionuar e amballazhuar ne pako letre 1 kg ku te jete shenuar
- Emetimi I prodhuesit
- Emri I produktit
- Pesha neto ose vellimi I produkti
- Data e prodhimit dhe skadimit
- Kushtet e vecanta te ruajtjes
- Rekomandime per perdorim ,nese keto ndikojne ne menyre te ndjeshme mbi afatet e ruajtjes se cilesise ose mbi vlerat e produktit ushqimor .keto te dhena te jepen mbi amballazh dhe etikete.

Kripe e jodizuar bazuar ne STAZH1437/01.07.1995

- Ngjyra te jete e bardhe ,e imet pa lageshtire dhe e jodizuar
- Te jete mase kokrrizore
- Treguesit fizik- kimike te jene sipas Standarteve Shteterore Shqiptar.
- E amballazhuar ne pako 500 gr ose 1 kg ku te jene te shenuar data e skadences mbi nje vit nga data e furnizimit

Salce domate :

- Te jete nga pamja mase pastoze me pjese te dukshme te perberesve te saj dhe pa pjese te djegura.
- Te kete ngjyre te kuqe deri e kuqe e thelle

-
- Me shije dhe ere karakteristike te salces se domates
 - Te kete treguesit kimik ne perputhje me standartet shteterore shqiptar
 - Amballazhimi te jete ne shishe 700 gr.

Recel frutash:

- Te mos jete FIKU,te jete cilesor me ngjyre dhe shije karakteristike.
- I etiketuar sipas Standartit Shteteror Shqiptar.
- Te jete e amballazhuar ne ene te mbyllura hermetikisht me vellim 25-30gr .
- Te jete me date skadence mbi nje vit nga dita e furnizimit .
- te jete e shoqeruia me flete analize nga AKU dhe ne etikete te jete shenuar edhe emri I prodhuesit.

Embelsira te ndryshme

- Te jene cilesore ,te etiketuar sipas standartit shteteror shqiptar .
- Te jene te amballazhuar ne qese celofoni ku te jete shenuar data e skadences mbi nje vit nga dita e furnizimit.

Leng frutash :

- Te jene cilesore te etiketuar sipas standartit shteteror shqiptar
- Permbajtja min e lengut ose e puresete (% ne volum ne produktin e gatshem) jete 40-50 % .
- Te jete e amballazhuar ne kuti kartoni me vellim 250ml ku te jete shenuar data e skadences mbi nje vit nga dita e furnizimit.

SPECIFIKIMET TEKNIKE PER PRODUKTIN “MISH”

Kërkojmë që mishi me të cilin do të përdoret për dietat që do të zbatohen në Spitalin Rajonal Vlorë:

Mishi vici :

- Te jete cilesi e pare ,me muskulature te zhvilluar mire dhe jo ne gjendje te ngrire ,te mos kete shume dhjame dhe ne qofte se ketë të jetë ngjyrë i bardhë,veshka të mos jetë e mbuluar me dhjame më tepër se 50%,dhe kocka te mos duket pasi te jete mbuluar nga mishi.
- Mishi do te perbehet nga pjese e perparme dhe e pasme propocionalisht,koka ,melcia e zeze,e bardhe ,kembet si dhe te perbrendshmet nuk futen ne perberjen e mishit .
- Pjesa e shpatulles kofshe dhe gjoks duhet te jete e vulosur me vulen e kontrollit veterinar.
- Cdo parti mishi duhet te shoqerohet me certificate veterinare
- Vula e raportit veterinari te jene te lexueshme mire .
- Transporti te behet me mjete frigoriferike te licensuara nga Inspektoriati Veterinar.
- Treguesit kimik ne perputhje me Standartin Shteteror Shqiptar.

Mish i pules:

- Te jete I fresket, prodhim vendi dhe ne etikete te jete shenuar edhe origjina e prodhuesit.
- Pamja e jashtme e pules te jete ngjyre roze e celur qe anon ne te bardhe karakteristike te mishit te pules se fresket pa shtresa te teperta dhjami cilesi e pare .
- I shoqeruar me raport analize nga Inspektoriati Veterinar.
- Transporti te behet me mjete frigoriferike te licensuara nga Inspektoriati Veterinar.
- Treguesit kimik ne perputhje me Standartin Shteteror Shqiptar

SPECIFIKIMET TEKNIKE TË BULMETIT

Kërkojmë që qumështi dhe nënproduktet e tij te cilet do te jene perberes per dietat qe do te zbatohen ne Spitali Rajonal Vlorë jane

DJATHI :

- Të jetë i cilësisë I me këto karakteristika :
- Të ketë pamje homogjene ,formë të mirë dhe pa deformime , i fortë ,me erë dhe shije të kendshme
- Lënda e thatë të jetë jo më pak se 48 % , yndyra në lëndën e thatë të jetë 50% yndyra e përgjithshme të jetë 26 % ,kripa 5%.
- Të mos ketë mikroorganizma dhe djathi të jetë i konsumueshëm pas 60 ditësh nga dita e prodhimit .Lagështia të jete 15 %.
- Te jete i shoqeruar me flete analize nga AKU
- Ambalazhimi te behet ne voza plastike me vellim 5-30lit. Djathi ne voze qendron i mbuluar me shelliren fillestare.
- Mbi cdo ambalazh ne djath vendoset etiketa ne te cilen shenohen emri i prodhuesit, emri i produktit, pesha neto ose vellimi i produktit si dhe data e prodhimit.
- Transporti te behet me mjete te mbuluara dhe te destinuar per transport bulmeti.

GJALPI :

- Te jete gjalp prodhim vendi,me shije te mire,pa lende te huaja ne perberje, i fresket cilesor sipas standarteve shteterore
- Te jete i shoqeruar me flete analizen nga AKU dhe te jete i shoqeruar me etiketen e firmes prodhuese ne ambalazh dhe afatet kohore te perdorimit si dhe data e skadences te perkoje me skadencen ne fleten e analizes se AKU
- Gjalpi të ketë ngjyrë kremi në të verdhë me 81 %
- yndyrë ,17 % lagështi dhe 2 % lëndë e thatë.
- Transporti te behet me mjete te mbuluara dhe te destinuar per transport bulmeti.

QUMËSHTI :

- Të jetë qumësht lope e cilësisë së parë me 1.5% -2 % yndyre
- Qumështi që do të vijë në Spital të jetë prodhim i asaj dite dhe të ketë ngjyrë të bardhë ,erë të këndëshme ,pak i ëmbël pa shije te hidhur dhe djegese te percaktuar ne standartet shteterore .
- Ambalazhimi te jete ne shishe plastike me vellim 1 lit-1.5 lit I mbyllur me kapak hermetik shoqeruar me flete analizen leshuar nga AKU dhe afatin e perdorimit
- Transporti te behet me mjete te specializuara te shitesit ne oret e para te mengjesit.

QUMËSHTI PËR FËMIJË:

- Qumësht formule standarte 1
- Krem qumështi (PANA)

-
- Çaj mali

KOS:

- Te jete i zene me qumesht qe permbush karakteristikat e mesiperme.
- Te jete i ambalazhuar ne gota plastike 200gr.ne te cilet te tregohet firma prodhuese dhe afati i skadences

GJIZE :

- Te jete cilesor ,pa kripe ,pa njolla lende te huaj,te mos jete e hidhur dhe me shije te kendshme Brenda kushteve teknike.
- Te jete I shoqeruar me flete analize nga AKU dhe te kete etiketen e firmes prodhuese ne amballazh.
- Afati I skadences ne etikete te perkoje me daten e skadences ne fleten e analizes nga AKU
- Transporti te behet me mjete te mbuluara te destinuara per transport bulmeti.

DJATH KACKAVALL:

- Te jete I cilesise se mire. Djath lope ose dele, nga jashte te jete I paster pa lende te huaja, me kosistence te njetrajtshme I stazhonuar .
- Te kete shijhe dhe ere karakteristike te kendshme pa hidhesi .
- Prodhim vendi I shoqeruar me flete analize ku te kete emrin e prodhuesit dhe afatet e perdorimit.

PERIMET DHE ZARZAVATET E TJERA

Te jene te cilesise se pare, te fresketa, sipas stines te ambalazhuar ne menyre qe te mos demtohen gjate transportit.

VEZET :

- Te jene pule ,prodhim vendi
- Kokrra e vezes te jete e fresket, te kete emrin e prodhuesit dhe te jete shoqeruar me analizen e proves nga AKU.
- Te kete shenuar mbi levozhge kodin qe duhet te perkoje me kodin e vendosur ne fleten e analizes se AKU.

FRUTAT

- Te jene te fresketa cilesia e pare, sipas stines.

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Kryerja e shërbimit do të realizohet si me poshtë:

1. Sipërmarrësi do të përgatisë racionet e ushqimit bazuar në nevojat kalorike sipas dietave si dhe të numrit të të sëmurëve të shtruar në pavione dhe të personelit mjekësor në shërbim 24 orë.
2. Sipërmarrësi duhet të sigurojë të gjitha orëditet e pajisjet që nevojiten, për përpunim, gatim, shpërndarje dhe servirje deri tek pacienti, si dhe pajisje për ruajtje të zakonshme dhe në kushte frigoriferike.
3. Të disponojë mjete transporti të përshtatshme për transport të produkteve ushqimore, të cilat të plotësojnë të gjitha kushtet higjieno-sanitare sipas standarteve në fuqi. Automjetet të jenë të pajisura me certificate higjieno-sanitare të leshuar nga organet kompetente. Mjetet e transportit të jenë në pronësi ose me qera të subjektit.
4. Produktet ushqimore që do të përpunohen, do të depozitohen në ambientet e kuzhines që disponon sipërmarrësi të jenë të shoqëruara me flete analize përkatëse.
5. Mishi duhet të jetë mish vici i freskët vendi, cilesia e parë dhe i shoqëruar me raport mjekësor veterinar, bazuar në STASH 1441 /87.
6. Zarzavatet duhet të përdoren gjithmone të freskëta dhe asnjehere të konservuara si dhe duhet të plotësojnë kushtet përkatëse sipas STASH .Nuk lejohet zëvendësimi i artikujve ushqimore, që janë të përcaktuar sipas normave dhe dietave.
7. Për dietën 12, buka duhet të jetë buke diabetike.
8. Shpërndarja e ushqimit deri tek pacienti do të bëhet me pajisjet e përshtatshme për ambientet spitalore (karroca, pajisjet e termike), të cilat të jenë funksionale dhe për transportimin me ashensor.
9. Në raste të vecanta (epidemie ose sëmundje ngjitëse) shpërndarja e ushqimit do të bëhet me enë me një përdorim.
10. Personeli i shërbimit të këtyre uniforme ku të dallohet qartë logoja e sipërmarrësit dhe me ngjyrë të ndryshme nga ajo e personelit mjekësor.
11. Të bëhet gatimi dhe shpërndarja e ushqimit sipas dietave përkatëse deri tek reparti.
12. Sigurimi i makinerive, pajisjeve dhe materialeve të inventarit të imet dhe ndihmese për guzhinën dhe pavionet duhet të sigurohet nga sipërmarrësi, i cili duhet të përgjigjet edhe për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre.
13. Ushqimi duhet të serviret i ngrohtë për çdo vakt sipas orarit të përcaktuar. Nuk lejohet ushqimi i thate.

➤ **Forca e përditshme e ushqimit do të përbëhet nga:**

- 1- numri i pacientëve të shtruar në spital
- 2- numri i personelit të shërbimit 24-orësh

3 herë në ditë për pacientët adultë: -

- Mëngjesi, 07:00-08:00;
- Dreka, 11:30-12.30;
- Darka, 18:00-19:00;

5 herë në ditë për infantët (Pediatriinë);

- Mëngjesi, 07:00-08:00;
- Vakti ndërmjetëm 1, 10:00
- Dreka, 11:30-12.30;
- Vakti indërmjetëm 2, 15:00
- Darka, 18:00-19:00;

- Të drejten e ndryshimit të orarit për shpërndarjen e ushqimit e ka vetëm Drejtorja e Spitalit Rajonal Vlorë.
- Sipërmarrësi duhet të ruaj në raftet e vecanta në mjedisin e guzhinës, kampionet e ushqimit të gatuar e që shpërndahet për ngrenie për të tre vaktet. Afati i ruajtjes së

mostrave (kampioneve) është 24-ore. Kur ka denoncime për cilësinë e ushqimit, ky afat zgjat deri në zgjidhjen e problemit dhe kryerjen e analizave laboratorike.

- Ushqimi para se të shpërndahet detyrimisht duhet të kontrollohet nga personeli i caktuar në Spitalin Rajonal Vlorë për sasine dhe vetitë organoleptike si dhe për cilësinë e gatimit.
- Sipermarresi duhet të njoftojë përpara se të shpërndajë ushqimin, personelin e Spitalit për kontrollin e cilësisë së Ushqimit.
- Sipermarresi duhet që në çdo kohë të shoqërojë ushqimin e gatuar me dokumentacionin përkatës deri në konsumimin e plotë të tij.
- Personeli i kuzhines dhe shpërndarjes së ushqimit duhet të jetë i pajisur me librezën përkatëse shëndetsore .
- Aktiviteti i kuzhines dhe shpërndarjes së ushqimit deri tek pacienti do të ndiqet nga personat e caktuar nga Spitali si për shërbimin e ushqimit dhe për funksionimin e tij duke zbatuar urdherat e Drejtorisë.
- Spitali Rajonal Vlorë do të ndjek zbatimin dhe realizimin e kontratës gjatë gjithë periudhës së kontraktuar dhe do të vendos sanksionet përkatëse për mosrealizime sipas përcaktimeve në kontratë.
- Shërbimi i higjenes ka të drejtën e kontrollit sipas ligjit mbi inspektoriatin sanitar.
- Sipermarresi duhet që pas larjes së enëve të kryejë edhe sterilizimin e tyre.

➤ **SPECIFIKIMET TEKNIKE**

- ✓ Kapaciteti i kuzhinës duhet të jetë i tillë që të prodhojë rreth 345 racione në vakt.
- ✓ Operatori ekonomik përgatit ushqimin në mënyrë të përqëndruar në kuzhinë çdo ditë në bazë të numrit të të shtruarve bazuar sipas përcaktimeve të dietave të kartelës së pacientit, vënë nga mjeku kurues përkatës , si dhe të personelit mjekësor që është në shërbim 24 orë. Në të gjitha rastet dhe për të gjitha vaktet, llogaritja e racioneve sipas dietave bëhet nga përgjegjësi i Sektorit të Hotelerisë, çdo ditë.
- ✓ Çdo ditë, kryeinfermieri në bashkëpunim me shefin e shërbimit, harton forcën ditore totale për pacientët e shërbimit dhe brenda orës 13.30 e dërgon pranë Sektorit të Hotelerisë.
- ✓ Sektori i Hotelerisë, harton pasqyrën përmbledhëse, bazuar në fletë forcat ditore sipas racioneve apo dietave duke shtuar dhe numrin e personelit mjekësor që trajtohet me ushqim gjatë shërbimit 24 orësh.
- ✓ Kontraktuesi përgatit dhe shpërndan ushqimin për personelin mjekësor që është në shërbim 24 orësh në vendin që do të caktohet për këtë qëllim.
- ✓ Makineritë, pajisjet dhe materiali i imët dhe ndihmës si për kuzhinën dhe për pavionet do të sigurohen nga kontraktuesi, i cili do të përgjigjet për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe pastrimin e tyre.
- ✓ Pasqyra përmbledhëse e përgatitur nga Sektori i Sektorit të Hotelerisë, i dorëzohet përgjegjësit të kuzhinës së operatorit ekonomik çdo ditë brenda orës 14:00, e cila shërben si porosi për ditën e nesërme.
- ✓ Transporti i ushqimit të përgatitur në kuzhinën kryesore deri në pavion dhe më tej tek pacienti, realizohet nga operatori ekonomik me enë të posaçme të mbyllura hermetikisht, apo (termuse) të llojeve dhe madhësive të ndryshme në funksion të sasisë që ofrohet si dhe për të ruajtur nivelin kulinar të ushqimit dhe temperaturës. Ushqimet

-
- dorëzohen nga kontraktuesi në minikuzhinën e spitalit në varësi të kontraktuesit duke shpërndarë ushqimin deri tek shtrati i pacientit, për ta tërhequr më pas, pas një ore.
- ✓ Të gjitha termuset dhe enët që transportohet ushqimi duhet të jenë detyrimisht me material inoxi dhe mbyllje hermetike për të ruajtur produktet nga agjentet atmosferike.
 - ✓ Ushqimet duhet të përgatiten në racione individuale sipas dietave të përcaktuara nga mjeku.
 - ✓ Këto racione duhet të përgatiten në minikuzhinë dhe të shpërndahen me karrela të lëvizshme me kate, të vendosen në tabaka të veçanta sipas dietave për çdo pacient. Ky ushqim duhet të serviret detyrimisht i mbuluar me qese plasmasi (rulon), për të ruajtur higjienën kulinare.
 - ✓ Ushqimet e përgatitura në racione individuale sipas porosisë së një dite më parë, të shpërndahen në pavione, si më poshtë:

3 herë në ditë për pacientët adultë:

Mëngjesi, 07:00-08:00;
Dreka, 11:30-12.30;
Darka, 18:00-19:00;

5 herë në ditë për infantët (Pediatriinë):

Mëngjesi, 07:00-08:00;
Vakti ndërmjetëm 1, 10:00
Dreka, 11:30-12.30;
Vakti indërmjetëm 2, 15:00
Darka, 18:00-19:00;

- ✓ Baza materiale për shpërndarjen e ushqimit për secilin pacient si dhe për kuzhinën duhet të sigurohet nga sipërmarrësi.
- ✓ Sipërmarrësi brenda si përfaqësues i kuzhinës duhet të realizojë larjen dhe desinfektimin e enëve dhe pajisjeve që përdoren brenda në pavion.
- ✓ Sipërmarrësi në këto ambiente konsumon ujë dhe energji elektrike për të cilat duhet të bëjë pagesat përkatëse sipas matësave që do t'i vendosë brenda këtyre ambienteve.
- ✓ Enët që përdoren për shpërndarjen e ushqimit tek pacientët duhet të jenë me material jo të dëmshëm për shëndetin. Ato nuk duhet të jenë absolutisht plastike.
- ✓ Ushqimet si kosi, gjalp, reçeli, etj., duhet të jenë detyrimisht të paketuara me ambalazh një përdorimsh.
- ✓ Sipërmarrësi përgatit dhe shpërndan ushqimin për personelin që është në shërbim 24 orësh.
- ✓ Materiali një përdorimsh dhe materialet larëse duhet të mbulojnë nga kontraktuesi.
- ✓ Personeli mjekësor konsumon ushqimin pranë vendit të punës, të paketuar sipas standardeve.
- ✓ Ngarkesa e personelit që kryen shpërndarjen e ushqimit në pavione është e ndryshme nga një pavion në tjetrin, sipas specifikave:
 - Numri i shtretërve;
 - Veçoria e të sëmurit; - të sëmurë rëndë.

- ✓ Punonjësit e shpërndarjes duhet të jenë të pajisur me uniformë si dhe me mjete e shenja dalluese përkatëse të kontraktuesit, me mirëkuptim të AK.
- ✓ Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës nëse A.K. konstaton se personi kryen veprime të jashtëligjshme gjatë ushtimit të profesionit të tij.
- ✓ Punonjësit duhet të sillen me edukatë dhe kortezi si gjatë zhvillimit të shërbimit dhe gjatë qarkullimit brenda ambjenteve të spitalit.
- ✓ Personeli duhet të jetë i pajisur me kontratë të rregullt pune, kuk ryhet pagesa e sigurimeves hoqërore e shëndetësore, si dhe të jetë i pajisur me librezë shëndetësore nga Inspektoriat Sanitar Shëndetësor.
- ✓ Sigurimi i të gjitha artikujve ushqimore do të jetë sipas kalorive përkatëse të miratuara.
- ✓ Llojshmëria e ushqimit duhet të jetë sipas sezonit, sasia dhe cilësia do të jenë të përcaktuara sipas programit të menuesë së përgatitur në baze të dietave dhe kalorive të konfirmuara nga mjeku dietolog.
- ✓ Kontraktuesi duhet të sigurojë ushqim të sigurtë, të freskët, të mbrojtur nga kontaminimet.
- ✓ Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të ushtrojë kontroll në ambjentet e kuzhinës, në prani të përfaqësuesit të Kontraktorit.
- ✓ Ushqimet do të nën shtrohen kontrollit të analizave, biologjike, kimike dhe fizike për të siguruar standartet e të ushqyerit.
- ✓ Kontraktuesi duhet të sigurojë ambjente me temperaturën e duhur për ruajtjen dhe mbrojtjen e ushqimeve në kuzhinë.
- ✓ Kontraktuesi duhet të marrë përsipër evadimin e mbeturinave të prodhuara gjatë procesit të përgatitjes së ushqimit. Ndërsa, mbeturinat pas konsumit të ushqimit duhet të depozitohen të ambalazuara dhe etiketuara në vendin që do të përcaktohet nga struktura përgjegjëse e AK.
- ✓ Në pavionet e të sëmurëve infektivë, shpërndërja e ushqimit do të kryhet me material njëpërdorimsh.
- ✓ Ushqimet që janë gati për konsum duhet të ndahen në porcione dhe duhet të shpërndahen në pavione, në oraret e caktuara.
- ✓ Përgatitja e pjatave, pirunjve, lugëve e tabakave, si dhe pastrimi i mëtejshëm është detyrë e personelit të Kontraktuesit.

Për kryerjen e shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes të ushqimit deri tek pacienti :

- Operatori i kontraktuar, duhet të përgatisë ushqimin në mënyrë të përqendruar në kuzhinën që ai vetë ka në pronësi ose qera/përdorim, për të gjithë pacientet shtruar në Spitalin Rajonal Vlorë dhe të personelit mjekësor në shërbim 24 orësh, bazuar në përcaktimin dietik të karteles së pacientit si dhe të verifikimit të forcës ditore nga Dega e Hotelerisë dhe me pas të shpërndanë deri tek shtrati i pacientit.
- Operatori i kontraktuar transporton ushqimin e përgatitur nga kuzhina qendrore që ai vetë duhet të disponojë, deri në pavionin përkatës, me mjetet, pajisjet dhe enët e veta dhe po me mjetet e veta kryen shpërndarjen deri tek shtrati i pacientit.
- ✓ Spitali Rajonal Vlorë në cdo shërbim ka kontraktuar një minikuzhinë, i cili do të jepet “në përdorim” operatorit ekonomik fitues, duke qenë se nuk jemi përpara kushteve për zbatimin e Vendimit Nr.54 datë 05.02.2014”Për përcaktimin e kriterëve të procedurës së menuesë së dhenies me qera ,enfiteoze apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore” Për këto ambjente, operatori ekonomik do të marrë përsipër shpenzimet për furnizimin me ujë të pijshëm dhe energji elektrike.Keto minikuzhina do të shërbejë për mbajtjen e inventarit të imet dhe shpërndarjen e ushqimit nga ana e operatorit ekonomik.

Materialet dhe mjetet profesionale të domosdoshme/inventari i imët, që OE pjesëmarrës duhet të deklarojnë disponimin ose mundësinë e disponimit të tyre, të nevojshëm për ekzekutimin e kontratës/kontratave që do të lidhen në zbatim të marrëveshjes kuadër:

Emërtimi	Njësia	Sasia
Boliere ngrohje uji	Copë	4
Tigan i madh profesional (braziere)	Copë	1
Dhoma frigoriferike	Copë	1
Frigorifere freskues/ngrirës	Copë	2
Frulatore	Copë	1
Sobë me Furrë profesionale	Copë	1
Makinë grirës mishi	Copë	1
Makinë grirës zarzavatesh	Copë	1
Karrela shërbimi në kuzhinë	Copë	3
Karroca transporti ushqimi	Copë	1
Karroca termike shërbimi ushqimi (banjomari)	Copë	4
Karroca shërbimi përmbledhje tabaka shërbimi	Copë	6
Lavamane inox	Copë	5
Peshore të ndryshme	Copë	6
Qeruese patatesh	Copë	1
Shtrydhëse frutash	Copë	1
Trung mishi	Copë	1
Tavolina pune inox	Copë	4

Inventari i Imët

Emërtimi	Njësia	Sasia
Gota uji	Copë	120
Kana uji	Copë	12
Kuti polisteroli shërbimi	Copë	20
Lugë tavoline	Copë	120
Pirunj tavoline	Copë	120
Pjata	Copë	120
Tabaka vetëshërbimi	Copë	120
Kupa	Copë	120
Tasa të thella	Copë	120
Tava inox madhësi të ndryshme	Copë	30
Thika tavoline	Copë	120

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet: Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi në Spitalin Rajonal Vlorë

Afatet e ekzekutimit:

Sherbimi	Përshkrimi	Shuma	Vendi i ekzekutimit	Afati i ekzekutimit
Shërbim gatimi dhe shpërndarje ushqimi Spitali Rajonal Vlorë	Sipas specifikimeve teknike dhe termave të referencës	Sipas Shtojcës 2	Spitali Rajonal Vlorë	Sipas nevojave të AK, brenda periudhës së vlefshmërisë së marrëveshjes kuadër

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve: Ofrim i shërbimit sa më cilësor të shërbimit të gatimit dhe shpërndarjes për pacientët e hospitalizuar në shërbimet spitalore të Spitalit Rajonal Vlorë.

Detyrat: Sipas specifikimeve teknike

Shpërndarja: Sipas specifikimeve teknike

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Në ambjentet e Spitalit Rajonal Vlorë.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortaku, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.

i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

